



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**URDHËZIM**  
**NR.2 DATË 15.05. 2003**

**MBI HETIMIN E VEPRAVE PENALE TË TRAFIKIMIT TË QËNIEVE**  
**NJERËZORE**

**Nisur nga** konstatimet e bëra gjatë studimit të dosjeve të procedimeve penale të hetuafa për trafik qëniesh njerëzore (kryesisht të femrave për htrim prostitucioni nga prokurori të ndryshme.

**Me synim**

për të rritur efektivitetin dhe cilesinë e veprave procedurale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në drejtim të provueshmërisë së akuzës dhe dënimit të autorëve të kryerjes së këtyre veprave penale,

për të mbrojtur dhe trajtuar me kujdes viktimat e këtij trafiku femrat e trafikuar ) në përputhje me të drejtat e garantuara nga aktet ligjore të brendshme dhe ato ndërkombëtare.

**Bazuar në** Kodin e Procedurës Penale, neni 24/4.

Ligjin Nr.8737, datë 12.02.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 2, pika 8.

Ligjin Nr. 8920, datë 11.07.2002 "Për ratifikimin e Konventes së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj" (neni 25 i Konventës, nenet 5 dhe 16 të protokollit kundër trafikut).

**U D H Ë Z O J :**

1. Për drejtimin dhe ndjekjen e hetimeve të veprave penale të trafikimit të qënieve njerëzore drejtuesit e prokurorive duhet që të caktojnë prokurorë me përvojë dhe eksperiencë në hetimin e këtyre lloj veprash penale.
2. Në të gjitha procedimet që hetohen për trafik qëniesh njerëzore të aktivizohen për kryerjen e veprimeve procedurale edhe shërbimet e policisë gjyqësore të strukturave anti-trafik në Ministrinë e Rendit Publik.
3. Gjatë hetimeve në procedimet penale për trafikim qëniesh njerëzore të vlersohet sigurimi i provës për thëniet e të dëmtuarave, si një moment shumë i rëndësishëm për provueshmërinë e akuzës. Në të gjitha rastet kur do të bëhet sigurimi i provës, prokurori duhet të komunikojë paraprakisht me dëshmitaren, duke e njohur me rëndësinë që ka ky fakt për dënimin e autorit, me rrethanat dhe procedurat sipas të cilave do të zhvillohet seanca e sigurimit të provës, dhe fakte të tjera që do të gjykohen të domosdoshme nga

- prokurori rast pas rasti.
4. Të dëmtuarat duhet të pyeten në mënyrë të hollësishme për të siguruar sa më shumë detaje dhe fakte në lidhje me ecurinë e ngjarjes. Të dhënat e siguruara gjatë pyetjes të të dëmtuarave të bëhen objekt hetimi i mëtejshëm për të arritur në sigurimin e sa më shumë provave dhe fakteve që vërtetojnë pretendimet e personit të trafikuar në lidhje me mekanizmin e ndodhjes së ngjarjes dhe identifikimin e autorit të kryerjes së veprës penale,
  5. Gjatë marrjes së kallzimit dhe pyetjes në prokurori dhe gjykatë së personave të trafikuar të mbahet në konsideratë fakti që ato janë persona të demtuar moralisht dhe fizikisht, të mbahet në konsideratë fakti që nuk duhet të dëmtohet më shumë personaliteti i tyre duke i trajtuar si femra me "moral te leq", apo se vetë kanë dashur të ushtrojnë prostitucion, etj.
  6. Gjate hetimeve të këtyre veprave penale duhet të mbahej në konsideratë kërkesat dhe detyrimet e parashikuara në "Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj", ***për mbrojtjen ligjore, masat ndihmëse dhe përgjegjësi në penale të viktimave të trafikut***. Për një kuptim dhe zbatim të drejtë të kërkesave të kësaj Konvente duhet që të gjithë drejtuesit e prokurorive të organizojnë punën për njohjen esaj nga të gjithë prokurorët ( Konventa dhe dy protokollet shtesë është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.41 të vitit 2002 ).
  7. Për një hetim të plotë të rasteve të trafikut duhet që prokurorët të orientojnë dhe urdhërojnë kryerjen e veprimeve procedurale për identifikimin dhe sekuestrimin e pasurive të fliuara nga autorët e kryerjes së këtyre veprave me të ardhurat e siguruara nga trafiku.
  8. Për çdo procedim, në përfundim të hetimeve, të zhvillohen analiza të përbashkëta me strukturat anti-trafik të shërbimeve të policisë gjyqësore në Ministrinë e Rendit Publik. Analiza duhet të shërbejë për të identifikuar të gjitha mundësitë për sigurirnin e sa më shumë provave, në favor të akuzës.
  9. Në çdo rast kur vendoset pushirri i hetimëve për procedimet penale për trafikim të qënieve njerëzore, një kopje e këtij vendimi duhet të dërgohet në Drejtorinë e Krimit të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe duhet që me vendimin të njihen personat e trafikuar që kanë bërë kallzimin.
  10. Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen prokurorët dhe drejtuesit e prokurorive të të gjitha niveleve, si dhe Drejtoria e Krimit të Organizuar në Prokurorinë e Përgjithshme.
  11. Mospërbushja e detyrave të përcaktuara në këtë Udhëzim përben shkelje të disiplinës në punë, neni 32, germa "b" e ligjit nr. 8737 datë 12.02.2001 «Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.
  12. Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**THEODHORI SOLLAKU**

**PROKUROR I PËRGJITHSHEM**

